



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM<sup>1</sup>

Nr. 553, datë 15.7.2020

PËR  
MIRATIMIN E LISTËS SË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE TË  
INFORMACIONIT DHE TË LISTËS SË INFRASTRUKTURAVE TË  
RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

(I ndryshuar me VKM Nr. 761, datë 12.12.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të cilët identifikohen për herë të parë me këtë vendim, të përcaktojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pikën e kontaktit, person përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t’ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
4. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë të paktën nivelet minimale të kërkesave të sigurisë së informacionit, të miratuara nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike kontrollon zbatimin e masave të sigurisë nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.
5. Vendimi nr. 222, datë 26.4.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, shfuqizohet.
6. Ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

<sup>1</sup> Ky projektvendim është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2016/1148, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 korrik 2016, “Lidhur me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në BE”, numri CELEX 32016L1148, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 194, datë 19 korrik 2016